



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.

08-04-2025

Nr.

2928

PRISHTINË - A

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 dhe Plotësim Ndryshimit të UA 03/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik si dhe në bazë të Kodit të punës nr. 804 i datës 28.01.2025 të KEK sh.a, si dhe nevojave emergjente të paraqitura për plotësimin e vendeve të lira të punës në tri Divizionet e KEK.sh.a (Divizionin e Prodhimit të Qymyrit, Termocentrali Kosova A dhe Termocentrali Kosova B), UD Kryeshefi Ekzekutiv i KEK-ut autorizon Drejtorin e Burimeve Njerëzore më 08.04.2025 që të publikojë konkursin për pozitën e mëposhtme:

KONKURS

Titulli i pozitës:	Teknik i makinerisë
Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës:	04-01.04.2025
Tipi Akt Emërimit të punës:	Sipas Ligjit të punës 03/L-2012, UA01/2024, plotësim ndryshimi i UA 03/2025 dhe Kodi i punës së KEK-ut
Titulli i mbikëqyrësit:	I raporton prijësit të ekipit
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Koeficienti-paga:	Minimumi 706.00 Euro
Procedura e aplikimit:	1 jashtëm
Numri i kërkuar:	180 (kryrës)
Vendi i punës:	Korporata Energjetike e Kosovës (Divizioni i Prodhimit të Qymyrit, TC Kosova A dhe TC Kosova B)

Detvat dhe përgjegjësitë:

Bartësi i kësaj pozite do të përgjigjet për punët në repartet makinerike në njërin nga këto lokacione: Divizioni i Prodhimit të Qymyrit, TC Kosova A dhe TC Kosova B (si psh: repartet makinerike të eskavatorëve të thëngjillit; eskavatorëve të djerrinës; paluesit të djerrinës; sistemet e transportit të thëngjillit; salla e makinave; kaldajë/kaldatore; objektet e jashtëm; sistemi i transportit të hirit; sistemi i transportit të thëngjillit; pajimet makinerike në PKU; serviset/punëtoritë makinerike, ose në repartet tjera makinerike).

Kryen punët e mirëmbajtjes mekanike në njërin nga lokacionet e përmendura më lartë (varësisht se ku përcaktohet) sipas urdhërave të punës dhe udhëzimeve tekniko-teknologjike të dhëna nga inxhinierët e mirëmbajtjes mekanike apo edhe nga prijësi i ekipit. Është përgjegjës, përkujdeset dhe kryen punët në profesionin e makinerisë në punëtorinë elektrike dhe në teren. Është përgjegjës për punët si axhustator për mirëmbajtjen e gjendjes teknike (gatishmërinë teknike) dhe zgjidhjen e problematikës së mirëmbajtjes elektrike të stabilimenteve, veglërisë dhe pajisjeve tjera në Departamentin e Mirëmbajtjes mbi bazat e normave (standardeve) teknike adekuate, rregullave të KEK-ut të njohura me ligj dhe brenda kornizës së autoritetit dhe detyrave të tij. Kontrollon gjendjen e kushinetave.

Bën konservimin e detaleve të ndryshme gjersa të bëhet rifatimi (përshtjellja) i elektromotorëve, transformatorëve dhe pajisjeve tjera të ndryshme të cilët janë sjellë në punëtorinë elektrike nga terreni apo nga njësitë tjera të mihjes.

Në rast të dëmtimit të elementeve apo detaleve të ndryshme bënë zëvendësimin origjinal të tyre. Nëse nuk ka pjesë rezervë origjinale atëherë i punon ato nga materiali i ndryshëm në bazë të urdhërave profesionale të prijësit të axhustatorëve dhe eprorëve tjerë të punëtorisë elektrike.

Është përgjegjës për punët si axhustator për mirëmbajtjen e gjendjes teknike (gatishmërinë teknike) dhe zgjidhjen e problematikës së mirëmbajtjes makinerike të stabilimenteve, veglërisë dhe pajisjeve tjera në Departamentin e Mirëmbajtjes mbi bazat e normave (standardeve) teknike adekuate, rregullave të KEK-ut të njohura me ligj dhe brenda kornizës së autoritetit dhe detyrave të tij.

Respekton në mënyrë rigorozë udhëzimet tekniko-teknologjike për mirëmbajtje, të cilat janë përgatitur nga inxhinieri përgjegjës.

Kryen preventivat e përgatitura nga inxhinieri përgjegjës, dhe me shkrim, përmes formularëve të përgatitur të preventivave. Për problemet eventuale e informon prijësin e ekipit, me theks të veçantë ato probleme që kërkojnë ndaljen e pajisjes;

Kujdeset për makineritë/stabilimentet/pajimet, gjendjen teknike të tyre, veglave dhe të pajisjeve të cilat i përdor për kryerjen e punëve;

Duhet të dij të lexoj dhe kuptoj dokumentacionin teknik (vizatimet, skemat etj);

Bënë prerjen me gaz (autogjen) të detaleve të ndryshme makinerike, ngrohë me gaz detalet si dhe në rast nevojë bënë pikjen me aparat për saldimit elektrik, pjesët e përgatitura për saldimit;

Bënë pastrimin e pajisjeve. Pas përfundimit të punës e pastron vendin e punës duke larguar edhe pjesët e vjetra të ndërruara;

Respekton orarin e punës me përkushtim dhe disiplinë;

Kryen punët e dhëna nga prijësi i ekipit apo ndonjë epror tjetër në sistemin ku është caktuar të punojë. Te kërkojë ndihmë nga prijësi i ekipit për zgjidhjen e problemeve specifike;

I përgjigjet në çdo kohë thirrjes për intervenim dhe të vazhdojë punën sipas nevojave edhe pas orarit të rregullt të punës;

Zbaton të gjitha rregullat e sigurisë në punë;

Kryen edhe punë tjera me kërkesën e eprorëve të tij;

Raportimet:-I raporton prijësit të ekipit për punë të kryera dhe gjendjen e pajisjeve apo edhe inxhinierit të mirëmbajtjes si dhe prijësit të axhustatorëve.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet

Shkollimi: Shkolla e mesme teknike e makinerisë

Drejtim/dega: Drejtimi i makinerisë.

Profili: Teknik i makinerisë, Teknik (operator) i prodhimit, Mjeshtër mekanik (axhustator), Automekanik, Tornitor

Aftësi profesionale: Aftësi që të arrijë afate kohore, aftësi për punë ekipore

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

- Aplikacionin e shkarkuar nga web faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online te vegëza: **“Ngarko Aplikacionin e plotësuar”**
- Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e shkollës së mesme**, e skanoni në një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe pastaj e ngarkoni në aplikimin online te vegëza **“Ngarko dëshmitë e kualifikimit” si dhe dëshmin e përvojës se punës nëse keni është e dëshiruar**. Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

Mënyra e aplikimit

Aplikimi është online, ngarkoni dokumentet sipas kërkesave në konkurs. Aplikimi juaj është i kompletuar vetëm nëse e merrni e-mailin konfirmues. Për çdo paqartësi dhe për siguri në aplikim kontaktoni në numrin e telefonit: 038 501-401-2671 ose 045 355 111, por mund të shkruani edhe në e-mailin (ofertapune@kek-energy.com) për të vërtetuar aplikimin tuaj (vetëm nëse nuk keni pranuar e-mailin konfirmues).

Njoftimi me rezultatin e konkursit publik

Kandidatët do të njoftohen individualisht me rezultatin e këtij konkursi duke e respektuar Udhëzimin Administrativ nr. 01/2024, plotësim ndryshimin e UA 03/2024 dhe Kodin e Punës nr. 804 te datës 28.01.2025 për rregullimin e konkursit në sektorin publik.

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve:

Testi me shkrim vlerësohet deri (70) pikë;

Jetëpërshkrimi (CV) deri në dhjetë (10) pikë dhe

Intervista vlerësohet deri njëzet (20) pikë.

KEK-u fton të gjithë të interesuarit, në veçanti ato të gjinisë femërore, të aplikojnë për pozitën e publikuar.

Për më shume informata për poziten e lartpërmendur vizitoni web-faqen: www.kek-energy.com, ikona ‘Shpallje’ dhe mund ta shkarkoni aplikacionin për pozitën që aplikoni.

Në rast të pikëve të barabarta në fund të testimit (me gojë) përparësi do të kenë kandidatët nga komuna e Obiliqit dhe zonat tjera të rrezikuara konform ligjit nr. 05/I-044.

Vërejtje:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes si në vijim: **Nëse nuk e deklaroni që anëtar i familjes së ngushtë ju punon në KEK, në cilëndo fazë që vërtetohet, aplikacionet e juaja do të refuzohen.** Aplikacionet pas afatit nuk do të pranohen, ndërsa ato të mangëta ose që nuk janë në formatin e kërkuar më lartë do të refuzohen. Kandidati i suksesshëm do të sistemohet në pozitën për të cilën ka aplikuar sipas kësaj shpalljeje me një punë provuese prej 6 muajve, pastaj sistemohet në vendin e lirë të punës sipas Kërkeses së Divizionit të dërguara në Dërguesin, dhe në afatin prej 3 (tri) viteve nga dita e kontratës së parë nuk ka të drejtë ri-sistemimi në vend tjetër të punës, përveç në raste të jashtëzakonshme me lejin e KE të KEK-ut. Kalendar i përafërt: brenda 25 ditësh testi me shkrim, brenda 30 dite intervista me goje dhe vlerësimi i CV-së, njoftimi final brenda 10 ditësh pas përfundimit të intervistës me gojë, nëse nuk ka anketa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë sipas UA 01/2024, plotësimit ndryshimit të UA 03/2024 dhe në baze të Kodit të Punës nr. 804 te datës 28.01.2025.

Data e aplikimit deri më 23.04.2025 ora 24:00

Prishtinë, 08.04.2025

